



IOM International Organization for Migration

IOM Bern

Thunstrasse 11
P.O.Box 216
3000 Bern 6
Switzerland
Tel. (+41) 031 350 82 11
Fax. (+41) 031 350 82 15
www.ch.iom.int

www.tvrmidweb.org

KTHIM I PËRKOHSHËM DHE VIRTUAL

Projekti Migracioni dhe Zhvillimi Social-Ekonomik në Ballkanin Perëndimor (MIDWEB)

Për të kontribuar në rindërtimin dhe zhvillimin e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës sipas Rezolutës 1244 të KSKB, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Nëpërmjet Projektit MIDWEB IOM kontribuon në rindërtimin dhe zhvillimin e këtyre vendeve. Kjo realizohet duke dërguar në këto vende në mënyrë të përkohshme profesionistë me arsimim të lartë, me origjinë nga këto vende, të cilët jetojnë në Austri, Gjermani, Itali, Holandë, Zvicër dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Projekti është i orientuar nga kërkesa dhe fokusi i tij është tek rritja e kapaciteteve të organizatave lokale në sektorët e identifikuar.

Për të lidhur nevojat me përvojën dhe ekspertizën e mundshme, IOM Bernë bashkëpunon ngushtë me:

- misionet e tjera në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë;
- pikat e kontaktit të Diasporës në vendet e BE dhe Zvicër;
- aktorët lokalë;
- grupet e migrantëve dhe diasporës me qëndrim në vendet e BE dhe në Zvicër.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)

IOM është themeluar më 1951 nga disa shtete. Një nga aktivitetet e IOM përfshin transportin, mbikëqyrjen dhe risistemimin e migrantëve në të gjithë botën. IOM është i vendosur në më shumë se 132 shtete dhe punon së bashku me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe të shoqërisë civile.

Kush mund të marrë pjesë në Projektin MIDWEB?

Projekti, që do të zhvillohet deri në Nëntor 2012, u drejtohet:

- Migrantëve me arsimim të lartë të cilët kanë origjinën në një nga vendet e synuara dhe aktualisht jetojnë në Austri, Gjermani, Itali, Holandë, Zvicër ose Mbretërinë e Bashkuar;
- Organizatave publike dhe të sektorit privat në vendet e synuara.

Si funksionon ky projekt?

MIDWEB vendos migrantët e kualifikuar në vendin përkatës të synuar. Ata zgjidhen mbi bazën e aftësive dhe përvojës së tyre dhe nevojave specifike të vendeve të synuara. Kohëzgjatja e këtyre vendosjeve të përkohshme është dy muaj. Përveç një kthimi fizik, këta persona mund të transferojnë gjithashtu njohuri përmes platformave të edukimit në distancë.

Procedura:

1. Kandidatët e interesuar dërgojnë curriculum vitae (CV) të tyre dhe formularin e aplikimit të plotësuar te IOM. Në formularin e aplikimit kandidati/ja përcakton në cilin shtet dëshiron të shkojë, për sa kohë dhe në cilën disiplinë dëshiron të ndajë njohuritë e tij/saj ose burimet e tjera përkatëse;
2. IOM bën lidhjen e ekspertizës dhe përvojës së kandidatit me nevojat e organizatave në vendet e synuara. Nevojat janë të formuluara në Termat e Referencës;
3. Institucioni pritës në vendin e synuar përzgjedh kandidatin e duhur duke u konsultuar me IOM.

Cilat janë kushtet e përgjithshme për të marrë pjesë?

Aplikuesit duhet:

- të jetë me origjinë nga njëri prej vendeve të synuara;
- të kenë shtetësinë e një vendit të BE ose atë Zvicerane ose të kenë leje qëndrimi të përhershme;
- të kenë arsimim të lartë dhe të paktën tre vjet përvojë pune në fushën përkatëse;
- të kenë aftësi të mira komunikimi;
- të jenë të motivuar.

Kandidatët preferohen të kenë përvojë në mësimdhënie dhe punë me projekte.

Çfarë siguron IOM?

Personat e përfshirë në projektin MIDWEB marrin mbështetje logjistike dhe financiare gjatë angazhimit të tyre. Kjo mbështetje përfshin:

- rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit, kostove të akomodimit dhe të jetesës në vendin e synuar;
- asistencë në aplikimin për dokumenta zyrtare;
- orientim përpara nisjes dhe kujdesje pas kthimit të mëpasme;
- organizimin e transportit për në vendin përkatës;
- pajisje me sigurim gjatë udhëtimit;
- monitorim gjatë kryerjes së punës.

Informacion shtesë

Për më tepër informacion rreth projektit ose aplikimit, ju lutem kontaktoni me IOM. Nëse dëshironi të merrni pjesë në projekt, ju lutemi shkarkoni formularin e aplikimit nga faqja e internetit e MIDWEB TVR. Dërgoni formularin e plotësuar së bashku me CV tuaj (në gjuhën Angleze) tek IOM.



Ky projekt ka marrë asistencë financiare nga Programi 2 IPA 2009 me shumë përfitues i Komisionit Evropian.

—
Kjo përmbledhje informacioni gjendet edhe në gjuhë të tjera dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit e MIDWEB TVR.

Asnjë e drejtë mund të rrjedhë nga teksti në këtë përmbledhje informacioni.